

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Ndërtim palestre për kompleksin “Shkolla Qëndër Komunitare” për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45000000-7 - Punë ndërtimi, 45211350-7 - Punime ndërtimi për ndërtesa multifunksionale, 45212000-6 - Punime ndërtimi për ndërtesa për argëtim, sporte, kulture, çlodhje dhe restorante, 45212225-9 - Punime ndërtimi për salla sportive.

VLERA E FONDIT LIMIT: 56,323,750 (Pesëdhjetëegjashhtëmilionetreqindendjzetëetremijëe shtatëqindpesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë** ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, “Sigurimi i ofertës”, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik,i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77,pika 1/a dhe 2,të LPP,nenin39,pika 6/b, të VKM nr. 285,datë 19.05.2021,Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimitaponevojënjëoperatorët ekonomikë të regjistruhen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020-2021-2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë jo më e madhe se vlera e fondit limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet.**Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”**,ku parashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.*

si dhe bazuar nënenin **43, pika 2/b, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** , i ndryshuar ku parashikohet se:Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë jo më e madhe se vlera e fondit limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,si dhe Ligjin 9920 datë 19.05.2008 , për Procedurën Tatimore, neni 64 Deklarata Tatimore.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020-2021-2022**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur operatorët ekonomik ofertues janë në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika c, e ligjit nr.10091 datë.05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin 2022** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **dhe për vitin e fundit 2023 (këstet e maturuara)**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Megjese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të madhe se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, **është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet .**

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike, **Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas **shtojcës Nr. 9**, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje,
- Situacionin përfundimtar të objektit dhe faturën tatimore,
- Aktin e kolaudimit të objektit ,
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim,**ose** Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar të objektit dhe faturën tatimore,
- Aktin e kolaudimit të objektit ,
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim,**ose** Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar **në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,pika 4**,ku parashikohet se:

“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën

dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,ku parashikohet se:

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurën e hapur duhet të jetë:*a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;b)punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht **në një vlerë jo më të madhe se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**, për një objekt të vetëm, ose **jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në **5 vitet e fundit**, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nen kufirin e ulet monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht **në një vlerë jo më të madhe se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**, për një objekt të vetëm, ose **jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera **në 5 vitet e fundit**, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së Autoriteti Kontraktor.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,neni 39,pika 8,parashikohet se:*“Autoriteti/enti kontraktor,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë.10.09.1998,*“Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”*,(i ndryshuar),Udhezimi i K.M nr.2,datë.13.05.2005,*“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 *”Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “* te ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vërtetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 , pika 5/a 5/b, dhe nenin,55 pika 4/a,duhet të paraqesin **Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9,kontratat e sipërmarrjes, Situacionin përfundimtar të objektit dhe faturën tatimore , Aktin e kolaudimit të objektit, Çertifikatën e marrjes në dorëzim,ose Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim për punët e kryera me entet publike**, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar , koha e realizimit , dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të objektit si dhe vlerësimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor,elemente të nevojshëm për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë,të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate,të lëshuar nga institucioni përkatës MPPT/MTI/MIE e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

1. NP– 1 A Punime gërmimi në tokë
2. NP– 2 A Ndërtime civile dhe industriale
3. NP– 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

1. NS– 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
2. NS– 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
3. NS– 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
4. NS– 9 A Punime strukturore speciale.
5. NS– 12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit..
6. NS– 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
7. NS– 18 A Punime topogjeodezike
8. NS– 19 A Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë
9. NS– 20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.Ai duhet te sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në pdrputhje me standartet kombëtare ose europiane.."

Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar.	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës.	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse.	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respective.	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse.
PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI				
NP-1	Punime gërmimi në tokë	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NP-12	Punime të Inxhinierisë së Mjedisit	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
PUNIME SPECIALE NDERTIMI				
NS-2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NS-8	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NS-9	Punime strukturore speciale	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NS-12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NS-14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NS-18	Punime topogjeodezike	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NS-19	Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NS-20	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.

2.3.3 Stafi kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet

- a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:

1) Arkitekt	1 (një)
2) Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder	1 (një)
3) Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist	1 (një)
4) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik	1 (një)
5) Inxhinier Mekanik profili Konstruksione metalike	1 (një)
6) Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
7) Inxhinier Elektrik	1 (një)
8) Inxhinier Telekomunikacioni	1 (një)
9) Inxhinier Mjedisi	1 (një)

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**
- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**), i cili të jetë i pajisur me Çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.**

Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 78, pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 "Për Prokurimin Publik".(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Për 1(një) prej drejtuesve të mësipërm duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë "Për auditues energjistik" në ndërtesa, e lëshuar nga Agjensia për Eficiencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr.407 ,datë.19.06.2019.

Për inxhinierin mekanik duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë "Për sistemet e Ngrohjes-Ftohjes", e lëshuar nga shoqëri të licensuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Për Inxhinierin e Telekomunikacionit duhet të paraqitet edhe:

- *Certifikate CISCO CCNA (Cisco Certified Network Associate)* ose ekuivalent, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licensuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- b. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si mëposhtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, bazuar në [Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020](#) “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP” , ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë.10.09.1998 i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të këtë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj si dhe vendimin Nr.312, datë.5.5.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, ligjin nr.124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar, ligji nr. 116/2016 “Për performance e energjisë së ndërtesave si dhe Vendimi Nr.407, datë.19.6.2019, “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet çertifikata e audituesit energjistik”.

Janë kërkuar inxhinier e mësipërm për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e punimeve të preventivit ,projektit, specifikimeve teknike dhe të grafikut të punimeve që do të zbatohen si dhe kategorive përkatëse në licencen përkatëse të zbatimit.

Arkitekti duhet për zbatimin e saktë të punimeve të ndarjeve dhe interireve të brendshme dhe zbatimin sipas detajeve arkitektonike të fasadës lidhur me zërat e preventivit të punimeve.

Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi dhe për realizmin e saktë të kuotave, referuar preventivit.

Inxhinieri i Ndërtimit i Profilit Strukturist duhet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit që do të ndërtohet, referuar specifikimeve në projektin konstruktiv persa i perket lidhjes se strukture metalike me bazamentin prej betoni b/a, traret lidhes b/a, brezat b/a, arkitraret b/a, kollonoat monolite b/a, soletat dhe hekurin e ndertimit per perforcimin e ketyre strukturave mbajtese dhe lidhese.

Inxhinier Ndertimi i Profilit Gjeoteknik duhet pasi ekspertiza e nje inxhinieri te tille eshte e diktuar ngushtesisht me proceset e punes te parashikuara qartesisht ne projekt – preventiv. Per me teper duke patur parasysh qe punimet do te kryen ne nje zone me sismicitet te larte vertetuar kjo dhe nga termeti i fundit i vitit 2019 kujdesi dhe nevoja per staf te kualifikuar aq me teper per stafin tekniko – inxhinierik qe ka te beje me shkencat e tokes si inxhinieri gjeoteknik eshte e qarte.

Inxhinieri Gjeoteknik ndjek dhe vlereson punimet e germimit deri ne tabanin e themelit per te evidentuar nese ka terren apo zona te paqendrueshme dhe propozon menyren e stabilizimit te tyre ne rast se paraqiten te tilla. Prania e domosdoshme e inxhinierit Gjeoteknik kerkohet per percaktimin e karierave te materialeve qe do te perdoren ne veper duke filluar nga shtresat e themelit dhe deri tek materialet qe do te perdoren ne bazamentin e objektit, ndjek dhe verifikon kapacitetin e terrenit dhe lidhjen e tij me llojin e zgjedhur te themelit.

Inxhinier Mekanik Profili Konstruksione Mekanike duhet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit që do të ndërtohet, referuar specifikimeve në projektin konstruktiv persa i perket krijimit dhe lidhjes së struktues metalike.

Nje strukture metalike ne rastin e nje kapanoni përgjithësisht eshte e perbere nga këto elemente:

- Profile te ndryshme prej kryesisht prej çeliku
- Saldime
- Bullona
- Ribatina
- Elemente te ndryshme mekanizmash (kur kërkohen operacione te ndryshme, lëvizje)
- Si edhe përpunim te ndryshme (tornime, frezime, kalandrime, etj)

Te gjitha elemtet e mësipërm janë element te cilët janë ne kompetencën e nje inxhinieri mekanik. Gjithashtu këto elemente gjate llogaritjeve te tyre do te konsiderohen si ne ngarkime statike, ashtu edhe ne ngarkime dinamike apo ne mbingarkesat e castit, ku edhe ne kete rast nje inxhinier mekanik i ketij profili ka formimin e duhur per ti llogaritur ato.

Inxhinieri Hidroteknik duhet për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve hidrosanitare, sistemit te furnizimit me uje dhe sistemit te shkarkimit te ujerave te zeza dhe te shiut, referuar preventivit.

Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektrike, referuar preventivit.

Inxhinieri i Telekomunikacionit duhet për zbatimin e saktë të punimeve, pasi referuar preventivit te punimeve te zbatimit, nuk kemi vetem instalimet elektrike por edhe instalime per te cilat nuk perputhet ekspertiza e ing elektrik, por duhet ajo e njeing telekomunikacioni per faktin qe kemi instalim sistem kamerash, sistem komunkimi te te dhenave (plus ky i nderthurur edhe me sistemet kundra zjarrit, sinjalizimit etj). Kerkohet inxhinieri elektronik/telekumunikacion i cili do te ndjeke te gjithe instalimet e rretit data, referuar preventivit te punimeve te zbatimit.

Inxhinieri i Mjedisit duhet për zbatimin e saktë të punimeve të objektit q që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve të mjedisit. Zbatimi i projektit nuk duhet të ketë pasoja negative në mjedisin e zonës. Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis dhe gazrave në ajër, për kanalet e drenazhimit të ujërave, rreth perimetrit të zonës së punimeve. Gjithashtu jane parashikuar te kryhen punime gjelberimi dhe sisteme te jashtme si mbjellja e fidaneveve dhe shkurreve dekorative, stola dekorativ druri etj.

Për 1(një) prej drejtuesve të mësipërm duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë “Për auditues energjistik” në ndërtesa,e lëshuar nga Agjensia për Efiçensën e Energjisë në përputhje me VKM Nr.407 ,datë.19.06.2019.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) prej drejtuesve teknike të jetë i pajisur me çertifikatë “Për auditues energjistik” është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit dhe është e nevojshme dhe shumë e domosdoshme ekspertiza e një punonjësi i pajisur me çertifikatë për auditimin e energjise,për të ndjekur çdo proces pune që ka lidhje me efiçensën e energjisë për realizimin me sukses të projektit që do të kryhet.

Kërkesa është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, gërma “b” të ligjit nr. 124/2015 “Për efiçencën e energjisë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

- a. çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm”.

Sqarojmë se referuar zërave të preventivit, raporti paraprak i efikasitetit të energjisë nuk është hartuar në fazën e projektimit, kështu që bëhet e nevojshme prezenca e Audituesit të Energjisë në fazën e zbatimit”.

Për inxhinierin mekanik duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë “Për sistemet e Ngrohjes-Ftohjes”, e lëshuar nga shoqëri të licensuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Kërkesa sa më sipër është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit dhe është e nevojshme dhe shumë e domosdoshme ekspertiza e një inxhinier mekanik të trajnuar për instalimin e sistemit të ngrohjes me të gjithë komponentet përberës të këtij sistemi.

Për Inxhinierin e Telekomunikacionit duhet të paraqitet edhe:

- *Certifikate CISCO CCNA (Cisco Certified Network Associate)* ose ekuivalent, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licensuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Ky certifikim konfirmon njohuritë dhe aftësitë e një kandidati në lidhje me bazat e rrjetit, aksesin në rrjet, lidhjen dhe shërbimet IP, bazat e sigurisë dhe automatizimin dhe programueshmërinë. Kërkesa sa më sipër është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit si lidhjet e internetit dhe telefonise, instalimi i sistemit të vezhgimit IP, sistemi smart i MNZ etj.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier Ndërtimit jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë është e rëndësishme pasi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për pjesën e sheshit, zbrëthimin e projektit të zbatimit, punimet e përgjithshme të ndërtimit etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve .

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier gjeolog është parë e domosdoshme dhe e nevojshme për shkak se objekti është ndërtim i ri në toka të buta dhe me qëndrueshmëri të ulët dhe OE duhet të disponojë si **staf mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), një inxhinier **gjeolog**, i cili do të monitorojë dhe vlerësojë ndërtimin e ri kan dhe pllakës të themelit në lidhje me shtresat gjeologjike. Pra referuar zërave në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit të propozuar është parashikuar që projekti kalon nëpër formacione gjeologjike që kërkojnë ekspertizën e një inxhinieri **gjeolog**. Të gjitha punimet duhet të bëhen në prezencë të gjeologut në mënyrë që të merren rezultatet e parashikuara në projekt. Në këto kushte realizimi me sukses i të gjithë procesit kryhet nëpërmjet disponimit nga ana e operatorëve ekonomik të kapaciteteve teknike të përcaktuara në kriteret kualifikuese në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

c. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar / të kualifikuar**, si mëposhtë:

NR	EMERTIMI	
1	Teknik i mesëm ndërtimi	(1 person)
2	Teknik i mesëm Topograf ose Gjeodet ose Markshajder	(1 person)
3	Teknik i mesëm Mekanik	(1 person)
4	Teknik i mesëm Elektrik	(1 person)
5	Teknik i mesëm elektronik/specialist IT	(1 person)
6	Murator	(3 persona)
7	Suvatues	(1 person)
8	Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm	(4 persona)
9	Hekurthyes	(2 persona)
10	Karpentier	(2 persona)
11	Saldator dhe prerës së metaleve	(2 persona)
12	Pllakashtrues	(2 persona)
13	Hidroizolues	(2 persona)

14	Termoizolues	(1 person)
15	Specialist parketi	(3 persona)
16	Specialist për punime fasade	(2 persona)
17	Specialist gipsi	(1 person)
18	Bojaxhi	(2 persona)
19	Teknik pyjesh / Specialist gjelbërimi	(1 person)
20	Elektriçist	(2 persona)
21	Hidraulik	(2 persona)
22	Marangoz/Mobilier	(2 persona)
23	Instalues të paneleve diellore	(2 persona)
24	Specialist për sisteme ngrohje-ftohje	(2 persona)
25	Manovratorë mjetesh të rënda (1 Automakinist dhe 1 Eskavatorist)	(2 persona)
26	Shofer	(2 persona)
		47 punonjës

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës dhe dëshmi (diplomë ose çertifikatë), që të vërtetojë kualifikimin profesional lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licensuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit**.
- Shofer dhe Manovratorë mjetesh të rënda duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshminë e aftësisë profesionale nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.
- Për teknikët e mesëm duhet të paraqitet diploma ose dëftesa e përfundimit të shkollës së mesme profesionale si dhe të jenë të pajisur me dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

***Në rastin kur makineritë dhe pajisjet disponohen me qera, Shofer (2 persona), Automakinist (1 person) dhe Eskavatorist mjetesh të rënda (1 person), mund të disponohen nga operatori/et ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit, për të cilët nuk është e nevojshme të jenë në listëpagesat e shoqërisë.**

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Për punonjësit e sipër cituar operatorët ekonomikë duhet të paraqesin tabelën sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i çertifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
3					
4					
5					

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma c dhe ç ,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtyre kriterëve për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlllogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kërkesa sa më sipër për Teknik i mesëm ndërtimi 1 (nje) - është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, si nje ”urë lidhëse” ndërmjet inxhinierit/reve dhe punonjësve, në mënyrë që këtyre të fundit, tu shpjegohet në mënyrë sa më të kuptueshme projekti dhe detajet teknike të tij.

Kërkesa sa më sipër për Teknik i mesëm Topograf ose Gjeodet ose Markshajder 1 (nje) - është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit dhe rievimeve të ndryshme në objekt, sipas zërave të preventivit të punimeve, si nje ”urë lidhëse” ndërmjet inxhinierit/reve dhe punonjësve, në mënyrë që këtyre të fundit, tu shpjegohet në mënyrë sa më të kuptueshme projekti dhe detajet teknike të tij,për realizmin e saktë të kuotave referuar preventivit.

Kërkesa sa më sipër për Teknik i mesëm mekanik 1 (nje) -është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve mekanike, sipas zërave të preventivit të punimeve, si nje ”urë lidhëse” ndërmjet inxhinierit/reve dhe punonjësve, në mënyrë që këtyre të fundit, tu shpjegohet në mënyrë sa më të kuptueshme projekti dhe detajet teknike të tij.

Kërkesa sa më sipër për Teknik i mesëm Elektrik 1 (nje) -është i nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit,referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: instalimeve elektrike, si ”urë lidhëse” ndërmjet inxhinierit/reve dhe punonjësve, në mënyrë që këtyre të fundit, tu shpjegohet në mënyrë sa më të kuptueshme projekti dhe detajet teknike të tij.

Kërkesa sa më sipër për Teknik i mesëm Elektronik / Specialist IT 1 (nje) - është i nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit,referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: instalimeve te rrjetit dhe telekomunikacionit, si ”urë lidhëse” ndërmjet inxhinierit/reve dhe punonjësve, në mënyrë që këtyre të fundit, tu shpjegohet në mënyrë sa më të kuptueshme projekti dhe detajet teknike të tij.

Kërkesa sa më sipër për Murator 3 (tre) – jane te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit,referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: Mur me tulle te lehtsuara dopio deri 3m me llaç perzier M25.

Kërkesa sa më sipër për Suvatues 1 (nje) – eshte nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit,referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi mbi 8 m, Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah.

Kërkesa sa më sipër për Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm 4 (kater) – jane te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit,referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: pergatitjen e struktures metalike te objektit ne fjale ku konsiston ne vendosjen e profileve dhe mberthimin e tyre nepermjet bullonave te posacem.

Kërkesa sa më sipër për Hekurthyes 2 (dy) – jane te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit,referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht:për përzgjedhjen,prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit.

Kërkesa sa më sipër për Karpentier 2 (dy) – janë te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: për prerjen dhe montimin e strukturave të armaturës për hedhjen e shtresës së betonit si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.

Kërkesa sa më sipër për Saldator dhe prerës të metaleve 2 (dy) – janë te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit, për saldimin, drejtimin, bashkimin e detajeve të ndryshëm, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit .

Kërkesa sa më sipër për Pllakashtrues 2 (dy) – janë te nevojshëm për realizimin e punimeve sipas zërave të preventivit si: Shtrese me pllaka porcelanat importi ne tualete+ambiente teknike ngjitur me kolle, Shtrese me pllaka grez porcelanato, Shtrese pllaka mermeri t = 20 mm, Shtrese me pllaka veteshtrënguese (Gri) etj.

Kërkesa sa më sipër për Hidroizolues 2 (dy) – janë te nevojshëm për realizimin e punime të hidroizolimit me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve si: Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama, Hidroizolim ne nyje sanitare me dy shtresa mapej etj.

Kërkesa sa më sipër për Termoizolues 1 (nje) – është i nevojshëm për realizimin e punime të termoizolimit me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve si: Mbulim çatie me panele sanduich etj.

Kërkesa sa më sipër për Specialist parketi 3 (tre) – janë te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: Shtrese derrase e presuar OSB t=12mm, Shtrese e re parket ahu me ngjitje + rashinim + llakim, Lyerje me boje antirreshqitese etj.

Kërkesa sa më sipër për Specialist per punime fasade 2 (dy) – janë te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: Mure te jashtme (fasada) me panel Sanduic, Veshje e parapeteve dhe kontureve me alucobond bashke me aksesoret perkates, Vetrate alumini fasade me profil termik dhe me dopio xham. Xhami jashtem 6 mm termik e i temperuar 20 mm dhome e mbushur me gaz argon dhe xham triplex 3+3 ml etj.

Kërkesa sa më sipër për Specialist gipsi 1 (nje) – është i nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: Ndertim muri me kartonxhes t=10cm me dy shtresa, kunder lageshtires, Tavan me kartonxhes etj.

Kërkesa sa më sipër për Bojaxhinj 2 (dy) – janë te nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes sipas zërave të preventivit si: Boje termoplastike (paste) per dyshemene perreth fushes dhe vijejimin, Lyerje e fasades, tavaneve dhe mureve te brendshme me boje hidroplastike.

Kërkesa sa më sipër për Teknik pyjesh/ Specialist gjelberimi1 (nje) – është i nevojshem për realizimin e punimeve si: F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander", F.V. Fidane Peme dekorative etj.

Kërkesa sa më sipër për Elektracist 2 (dy) – janë te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit si instalimeve elektrike

Kërkesa sa më sipër për Hidraulik 2 (dy) – janë te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: instalimeve Hidraulike.

Kërkesa sa më sipër për Marangoz / Mobilier 2 (dy) – janë te nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: Dru i perpunuar (I kompletuar) per shkallet/uleset e spektatoreve, Veshje me dru dekorativ etj.

Kërkesa sa më sipër për Instalues te paneleve diellore2 (dy) – janë te nevojshem për realizimin e punimeve si: F.V Sistem panele diellore per prodhimin e ujit te ngrohte sanitar, e tipit me pasqyra, sipërfaqe totale absorbuese absorbuese 20m2, pressioni i punes 6 bar.

Kërkesa sa më sipër për Specialiste per sisteme ngrohje-ftohje 2 (dy) – janë te nevojshem për realizimin e punimeve si: Instalimi i sistemit te ngrohjes me te gjithë komponentet perkates.

Kërkesa sa më sipër për Shofer dhe Manovratorë mjetesh të rënda (1 Automakinist dhe 1 Eskavatorist) është i nevojshem për realizimin e punimeve të ndertimit.Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit e kualifikuar si më sipër, pasi kjo kërkesë lidhet ngushtësisht me mjetet e kërkuara në pikën 2.3.5, të dokumentave të tenderit, në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi, ku për drejtimin e mjeteve te vleresuara të domosdoshme për realizimin e punimeve në fjalë, nevojiten drejtuesit respektive, të pajisur me dokumentacionin përkatës, në përputhje me Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2.3.4 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të disponojnë minimalist në listëpagesat e muajit të fundit punonjës të specializuar / të kualifikuar,ku përfshihet stafi sipas **pikës 2.3.3 gërma a,b,c** si mëposhtë:

- a. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë/në në stafin e tij 1 (një) punonjës** që të disponojë dëshmi trajnimi si *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”* në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”*. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten: çertifikata e trajnimit për *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”*, e dhënë nga një organizëm i licensuar, shqiptar ose i huaj .

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.***(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* dhe 39, pika 6, gërma c dhe ç ,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,* i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, **për 1 (një) punonjës** që të disponojë dëshmi trajnimi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”*. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten: çertifikata e trajnimit për *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”*, është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit,mbi sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

- b. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.**

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimet në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Qëllimi për vendosjen e këtij kriteri është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve. Vlerësimin e ndikimeve negative mjedisore në kohën e duhur dhe parandalimin e tyre.

Duke qënë se punimet do të kryhen pandërprerë aktivitetin e përditshëm të punës së drejtorisë dhe në prani të shumë personave afër dhe brenda kantierit të ndërtimit dhe duke pasur parasysht vendin e ndërtimit, është parë e nevojshme disponimi i ekspertit të ndikimit në mjedis. Në pikën 4, Nenin 24 të ligjit Nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis” përcaktohet se licencat e këtyre ekspertëve përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor. Duke qene se ky proces nuk eshte ezauruar ne fazen e studim-projektimit, per kete arsye eshte pare e nevojshme vendosja e ketij kriteri per tu plotesuar nga operatori ekonomik i cili do te kryej punimet.

- c. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë/në në stafin e tij 1 (një) punonjës që të disponojë dëshmi trajnimit si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimet në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të

zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënëz zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilët janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

- d. Operatori/et ekonomike ofertues për punonjësit e kualifikuar (2 Karpentiere, 4 Pergatites të konstruksioneve metalike dhe 2 Specialiste për punime fasade) duhet të paraqesë certifikatë trajnimi "Për punime në lartësi", sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë, , në mënyrë që të kuptojnë dhe të ndjekin procedurat e punimeve.

Për të cilët duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe 39, pika 6, gërma c dhe ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. **Kërkesa sa më sipër për punonjësit trajnuar dhe të kualifikuar për punime në lartësi,** lëshuar nga një organizëm çertifikimi i pavarur i licencuar/akredituar në Republikën e Shqipërisë , në mënyrë që të kuptojnë dhe të ndjekin procedurat e punimeve, është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, mbi punimet që do të kryhen në lartësi.

- e. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë/në në stafin e tij **1 (një)** punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuareve të gazit dhe **1 (një)** punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe uje të nxehtë, sipas vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për të cilët duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimet në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për specialistin punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar si më sipër, është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion, dhe Vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.

Kjo kërkesë është vendosur referuar kërkesave të parashikuara në projektin mekanik, ku përfshihet instalimi i rezervuarit të gazit, nxehja e ujit nëpërmjet kaldajës me gaz, dhe dërgimi i ujit të nxehtë nëpërmjet tubove multistrad në radiatorët e klasave përkatëse duke bërë ngrohjen e ambientit. Thëksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen dhe rëndësisë së objektit në të cilin do zbatohet kontrata, është e domosdoshme prania e **1 (një)** punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuareve të gazit dhe **1 (një)** punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe uje të nxehtë.

Qëllimi i autoritetit kontraktor nuk është vetëm ndërtimi i palestrës sipas standardeve bashkëkohore, por edhe siguria në ambientet e saj. Duke qenë se në ambientet e palestrës do të montohen pajisje të cilat në përputhje me bazën ligjore të sipërcituar kryhen nga persona të licencuar/trajnuar, garanton autoritetin kontraktor për montimin e tyre si dhe për sigurinë në palestër.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i sipërcituar është hartuar në përputhje dhe vëllim të plotë me objektin e kontratës, duke garantuar AK për zbatimin e saj me sukses dhe në kohë.

- f. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 58 (Pesëdhjetëtetë) persona për muajin e fundit**, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, **për muajin e fundit.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi **për muajin e fundit.**

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” .

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur referuar zberthimit të zerave të preventivit duke u bazuar tek grafiku i punimeve të hartuar nga projektuesi, ku është parashikuar kryerja e ketyre proceseve Brenda afateve kohore të caktuara në grafik.

Nevojiten:

Teknik i mesëm ndërtimi (1 person)
Teknik i mesëm Topograf ose Gjeodet ose Markshajder (1 person)
Teknik i mesëm Mekanik (1 person)
Teknik i mesëm Elektrik (1 person)
Teknik i mesëm elektronik/specialist IT (1 person)
Murator (3 persona)
Suvatues (1 person)
Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm (4 persona)
Hekurthyes (2 persona)
Karpentier (2 persona)
Saldator dhe prerës së metaleve (2 persona)
Pllakashtrues (2 persona)
Hidroizolues (2 persona)
Termoizolues (1 person)
Specialist parketi (3 persona)
Specialist për punime fasade (2 persona)
Specialist gipsi (1 person)
Bojaxhi (2 persona)
Teknik pyjesh / Specialist gjelbërimi (1 person)
Elektriçist (2 persona)
Hidraulik (2 persona)
Marangoz/Mobilier (2 persona)
Instalues të paneleve diellore (2 persona)
Specialist për sisteme ngrohje-ftohje (2 persona)
Manovratorë mjeteve të rënda (1 Automaknist dhe 1 Eskavatorist)(2 persona)
Shofer (2 persona)

Personel kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, dhe mbështetes si mëposhtë:

Arkitekt	1 (një)
Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder	1 (një)
Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist	1 (një)
Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik	1 (një)
Inxhinier Mekanik profili Konstruksione metalike	1 (një)
Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
Inxhinier Elektrik	1 (një)
Inxhinier Telekomunikacioni	1 (një)
Inxhinier Mjedisi	1 (një)

Stafi mbështetës

Inxhinier Ndertimi 1 (një)

Inxhinier Gjeolog1 (një)

Stafi Drejtues,menaxhues ,mbështetës (11 persona)

Totali 58 persona

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

g. Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet te jenë në përputhje me objektin e prokurimit:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)
- ISO 45001-2018 (ose ekuivalente)
- ISO 14001:2015 (ose ekuivalente)
- ISO 50001:2018 (ose ekuivalente)

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Autoriteti kontraktor do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN; SSH/ISO mbi konformitetin e standardit europian apo atij ISO, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

VO: Nëse certifikatat nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes së objektit të kontratës,që do të prokurohet dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit.

Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

h. Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in për zërat e preventivit:

- **Kaldajë me gaz (110kw)**
- **Element radiator**
- **Tuba drenazhi te brinjezuar d=200mm**
- **Tuba PEX (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar $\delta=6$ mm**
- **Pllaka gipsi**
- **Parquet druri**
- **Sensorë termik tymi**
- **Sirena alarmi**
- **Profile per dritare dhe dyer plastike**
- **Hekur ndertimi periodik**
- **Celik per struktura metalike te perbera**
- **Hidroizolues me bazë cimento**
- **Llac për mbushje dhe suvatim**
- **Tullë**
- **Bojë hidroplastike**
- **Bojë termoplastike (paste)**

për rastet që operatori ekonomik **nuk është prodhues** duhet të paraqesi **autorizim prodhuesi, ose distributori të autorizuar ose marrëveshje** bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis **ofertuesit - distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi. **Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .**

Për Kaldajë me gaz (110kw)

Duhet të paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar në përputhje me standartin EN 15502 ose ekuivalente (*përse i përket sistemeve te ngrohjes me kaldaje gazi*).

Për Elemente radiator

Duhet të paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit në përputhje me standartin EN 442 ose ekuivalente (*sipas standartit european për ngrohjen me radiatorë*).

Për Tuba PEX (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar $\delta=6$ mm

Duhet të paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose e përputhje me standartin EN 1420 ose ekuivalente (*përse i përket kushteve higjeno-sanitare qe garantojne keto tuba*).

Për Pllaka gipsi

Duhet të paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin SSH: EN 520 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit (*Për pllakat e kartonit dhe gipsit*).

Për Parket druri

Duhet të paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 14342 ose ekuivalente (*përsa i përket dysHEMEVE dhe parketit prej druri*).

Për Sensorë termik tymi dhe Sirena alarmi

Duhet të paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 54 ose ekuivalente (*përsa i përket sistemeve të zjarrit dhe alarmit*).

Për Hekur ndertimi periodik,

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 10080 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit (*Përsa i përket shufrave te hekurit te ndertimit*).

Për Celik per struktura metalike te perbera,

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 10025 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit (*Përsa i përket celikut te perdorur ne struktura metalike*).

Për zërat e preventivit:

- **Hidroizolues me bazë cimento**
- **Llac për mbushje dhe suvatim**
- **Bojë hidroplastike**

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë raportet/certifikatat e testimi nga laboratorë të çertifikuar sipas standartit ISO/IEC 17025 ose ekuivalent. Përsa i përket bojës hidroplastike, Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë raportet/certifikatat e testimi nga **prodhuesi ose distributori** ku të vërtetohet se produkti është antibakterial dhe ekologjik, të lëshuara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit.

Për Tullë,

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 771 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit (*Përsa i përket karakteristikave te materialeve te muratures*).

Për Bojë termoplastike (paste),

Duhet të paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 13036 ose ekuivalente (*per rezistencen ne rreshqitje*).

(Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .)

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje.

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 84 ,“Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshtë e domosdoshme që secili material i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor të disponojë një autorizim prodhuesi,certifikatë cilësie,raport testimi dhe kontratë furnizimi në mënyrë që Operatori Ekonomik ofertues në rast të shpalljes fitues të mos abuzojë me cilësinë. Për ta vërtetuar këtë duhet që secili Operator Ekonomik pjesëmarrës të disponojë autorizim prodhuesi,certifikatë cilësie,raport testimi dhe kontratë furnizimi nga laboratorë të certifikuar nga institucione ndërkombetare ose kombëtare të akreditimit. Në rast të shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, Autoriteti Kontraktor së bashku me Mbikqyresin e Punimeve do të sigurohen që secili material që do të përdoret në objekt të këtë certifikaten ose raportin e testimit. Në këtë mënyrë raportet e testeve që i përkasin materialeve të linjave të prodhimit, do të jenë të njëjtat me ato të materialeve që do të vendosen në vepër, duke bërë të mundur përmbushjen e parametrave të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës max 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhir	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Betoniere min 150 litra	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Depozite uji 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Ngjeshes /Kompaktor	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Tranxhe per kthim hekuri	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Gjenerator	copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Total station	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Gps për matje topografike	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Saldatrice /Motosaldatrice	copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Kompresor ajri	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Makineri për bashkimin e tubave PEX	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Fabrike betoni jo me larg se 60 km	copë	1	Në pronësi / qira ose kontratë furnizimi

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi **58 copë**
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 2 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 copë.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori/et ekonomik duhet të paraqese:

- a) Për mjetet me rrota/goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme). Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.
- d) **Për fabrikën e prodhimit të betonit**
- a) në rast se është në pronësi të firmës, duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, bashkë me Aktin e Miratimit të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit .
- ose
- b) në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së bashku me dokumentat e kerkuara me sipër për fabriken e prodhimit të **betonit**.
- ose
- c) në rast të akt-marreveshjes së furnizimit të paraqitet akt-marreveshja e furnizimit me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së bashku me dokumentat e kerkuara me sipër për fabriken e prodhimit të **betonit**. Ajo duhet të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit, për të siguruar një cilësi sa më të lartë të specifikuar në markat e betonit. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e këtyre dokumentave përbën kusht për skualifikim.
- e) Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimet në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i **ndryshuar**, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM nr.629 datë.15.07.2015, manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave të tyre dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar VKM nr.629 datë.15.07.2015, “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, është bërë përllogaritja teknike e mjeteve/ makinerive/ pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës, nevojiten:

Emri i mjetit	Njesi	Sasi
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	copë	2
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	2
Kamioncine me kapacitet mbajtës max 3.5 ton	copë	1
Eskavator me zinxhir	copë	1
Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	copë	1
Betoniere min 150 litra	copë	2
Depozite uji 5000 litra	copë	1
Ngjeshes /Kompaktor	copë	1
Tranxhe per kthim hekuri	copë	1
Matrapik	copë	1
Gjenerator	copë	2
Total station	copë	1
Gps për matje topografike	copë	1
Saldatrice /Motosaldatrice	copë	2
Kompresor ajri	copë	2
Makineri për bashkimin e tubave PEX	copë	1
Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)	copë	1
Fabrike betoni jo me larg se 60 km	copë	1

Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtës min 10 ton dhe kapacitet mbajtës min 7–max 10 ton, Mjet që përdoret për transportin e materialeve bazuar në zërin e preventivit transport dheu,transport materiale ndërtimi.

Kamionçinë

Mjet që përdoret për transportin e materialeve të imëta sjelljen e tyre në objekt dhe transportin e materialeve të ndryshme brenda kantierit.

Eskavator me zinxhir

Mjet që përdoret për punime gjurmimi dhe hapjen e materialit të shtresave.

Autovinc

Mjet që përdoret për sjelljen e materialeve të nevojshme dhe shkarkimin e tyre në objekt për punime si spostimi i tubove të celikut dhe materialeve të rënda.

Betoniere 150 litra

Pajisje që përdoret bazuar në zërin e preventivit për punime betoni në zona ku është e pa mundur kalimi me Autobetoniere dhe Autopompë betoni.

Depozitë uji

Pajisje që përdoret për mbajtjen e sasisë së ujit që nevojitet për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve bazuar në zërat e preventivit .

Ngjeshes/ kompaktor

Pajisje që përdoret për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen është i nevojshëm për ngjeshjen e trotuareve në sheshin e palestrës.

Pajisje për hekurthyes tranxhe

Pajisje që përdoret për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen.Për përgatitjen e konstruksioneve të hekurit.

Matrapik

Pajisje që përdoret për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen.Për shpimin dhe shkatërimin e sipërfaqeve të konstruksioneve të ndërtimit dhe për hapjen e vrimave të dimensioneve të ndryshme në beton.

Gjenerator

Pajisje që përdoret për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen dhe realizimin me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht në momente kur nuk kemi energji elektrike.

Total station dhe Gps për matje topografike

Pajisje që përdoren për piktimin dhe kuotimin, pasi kemi matje topografike përsa i përket rievimeve dhe sistemeve të jashtme, etj.

Saldatrice /Motosaldatrice

Pajisje që përdoret për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve bazuar në zerat e preventivit për konstruksionet metalike , konkretisht në saldime ose ngjitje etj.

Kompresor ajri

Pajisje që përdoret për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen dhe realizimin me sukses.

Makineri për bashkimin e tubave PEX

Pajisje që përdoret për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen dhe realizimin me sukses, konkretisht **për bashkimin e tubave PEX.**

Kontenier Stacioner

Objekt që do të përdoret si zyrë në objekt.

Fabrikë betoni

Prodhimi i betonit të kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. Në bazë të preventivit është një sasi e madhe betoni për tu sjellë në kantier.

Në lidhje me vendosjen e kriterit Fabrikë betoni jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit argumentojmë teknikisht si mëposhtë vijon:

Nën nocionin transport të betonit nënkuptohet bartja e betonit nga vendi i prodhimit deri te vendi i vendosjes / shtruarjes të betonit.

Transporti është faktor shumë i rëndësishëm i cili ka ndikim të madh mbi cilësinë e betonit.

Elementet themelore në bazë të cilëve planifikohet transporti janë: lidhja e parakohshme dhe segregacioni i betonit. Përveç kësaj, transporti duhet të jetë i shpejtë, racional, të sigurojë mbrojtje nga avullimi i ujit, rrjedhja e qumështit të çimentos etj.

Transporti i betonit prej fabrikës për beton deri te punishtja quhet transport i jashtëm, kurse transportimi i betonit në vetë punishten quhet transport i brendshëm.

Këtu përfshihet transportimi nga repartet e punishtes dhe vendit për ri ngarkim deri te vendi ku betoni vendoset.

Largësia e fabrikës për beton deri te punishtja mund të jetë 50 e më tepër kilometra. Në distanca të këtilla transporti mund të kryhet vetëm me mjete transportuese nga tipi i automjeteve rrugore siç janë: Kamionët mikser të ashtuquajtur autobetoniere .

Kriteri i vendosur në pjesën e kapacitetit teknik në drejtim të vërtetimit të disponueshmërisë së *fabrikës së prodhimit të betonit jo më larg se 60 km*, është një kriter i drejtë dhe jopërrjashtues, përsa kohë ju ka krijuar operatorëve ekonomikë një gamë opsionesh që variojnë nga pronësia, tek kontrata me qira dhe akt-marreveshje furnizimi. *Njësia e prokurimit gjykon se kriteri i mësipërm nuk është diskriminues, nuk sjell kufizimin e pjesëmarrësve pasi OE mund të përzgjedhin pika të furnizimit me beton dhe inertet brenda rrezes prej 60 km vijë rrugore, në drejtim të aksit Ersekë - Tiranë si dhe në drejtim të aksit Ersekë - Leskovik - Gjirokastër duke mundësuar më shumë se një opsion.*

2.3.6 Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të hedhur në tender të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit **për 7 (shtatë) muaj.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë me një laborator testimi të betonit dhe hekurit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12350-2:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalent, SSH EN 6892-1:2019 ose ekuivalent.

Persa me sipër duhet të paraqitet:

- Kontrata me laboratorin testues përkatës
- Certifikata e akreditimit të laboratorit testues përkatës

Argumentimi: Kërkesa është vlerësuar e nevojshme si kërkesë teknike pasi objekti që do rikonstruktohet dhe ndërtohet është godine publike ku ka levizje dhe prani të shumta të njëzëve dhe për këtë arsye betoni dhe hekuri i përdorur në strukturën e kësaj godine duhet të jetë i garantuar sipas çelësive dhe standarteve të kerkuara.

2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Plan organizimin e punimeve të objektit ku të reflektoj të gjitha masat tekniko-organizative dhe elementët e tjerë që kërkon një plan organizimi të mirëfilltë.
- Planin e sigurisë në kantier për punimet në objekt në format sipas VKM nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr. 742 datë 06.11.2003”, sipas kërkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 është e lidhur me kërkesat teknike mbi menyren me grafikun e punimeve; fazat si dhe afatet e realizimit të punimeve.

Operatorët ekonomik të interesuar, në përgatitje të ofertës së tyre për procedurën e prokurimit të sipërcituar do të kenë në konsideratë se autoriteti kontraktor në momentin e zbatimit të kontratës do të lejohet të kryhet jo vetëm me **markat /prodhues, “Mapej” ‘Gevis’...**, si dhe për disa produkte që i kërkon **“Importi”, “Cilësi e I-rë”...**, por edhe **ekuivalente e tyre.**

Periodha e garancisë për defektet është **2 vjet pas marrjes në dorëzim të objektit** (hartimit të proces-verbalit të marrjes në dorëzim dhe certifikatës).

Argumentimi: Është vendosur ky njoftim duke u bazuar në ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë.10.09.1998 i ndryshuar pasi periodha e garancisë së punimeve referuar këtij ligji shkon nga 1 deri 2 vite.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë përgatitur nga hartuesi i projektit që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke qënë elemente përbërës të tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsiderat kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të Ligjit nr. 9290, datë.7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kërkesat e ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i përlogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të preventivit të hartuar nga hartuesi i projektit sipas VKM nr 629 datë 15.07.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”,

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **12.10.2023, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt, “**Ndërtim palestre për kompleksin “Shkolla Qëndër Komunitare” për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

- Dokumentat e tenderit
- Projekti
- Raporte Teknik
- Grafiku i punimeve
- Preventivi
- Specifikimet teknike

Njësia e Prokurimit